

## NDERHYRJE PR SHPETIMIN E KISHAVE - MONUMENTE KULTURE



Kisha e Shën Athanasit, Bularat – Gjirokastrë

Kisha e Shën Athanasit është një ndërtim i shek. XVIII dhe i përket tipit bazilikal me tri nefe. Ndërhyrjet restauruese kishin për qëllim rikthimin e funksioneve fillestare të saj.

Ato u përqendruan në konsolidimin e konstruksionit, duke vendosur tiranta në sistemin e mbulesës së brendshme, rimbullimin e çatisë me plloça guri, riparimin e portikëve në hyrjet perëndimore dhe jugore, ritrajtimin dhe plotësimin e narteksit dhe sistemin e territorit të jashtëm.

Ndërhyrja për shpëtimin e kishës u realizua me nismën, kujdesin dhe mbledhjen e fondeve financiare nga Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Anastasi.







[Kisha Ortodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)